

A K T T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Sunrise Beach Hotel” shpk

Date ____ .01.2025

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Z. Enver Mehmeti, i biri i Skenderit, lindur ne Durres, me 22.08.1962, shtetas shqiptar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me numer 035957983 dhe me nr.personsl G20822071P, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtare dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personi i mesiperm, eshte Ortak i Shoqerise.

Neni 1

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria eshte emertuar “Sunrise Beach Hotel” shpk

Neni 3

Shoqeria ka Seline e saj ne: Lagja Mjull Bathore, Rruga Dervish Shaba, Rrethrotullimi i qendres tregtare TEG, Blloku B1, Tirane.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Shoqeria “Sunrise Beach Hotel” shpk gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Shoqeria “Sunrise Beach Hotel” shpk zhvillon aktivitetin e saj me objekt si me poshte:

-Te ushtroje aktivitetin e fushen e hoteleri turizmit, bar restorante, floktore, komplekse e palestra sportive, fusha tenisi e minifutbolli, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojeshme dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi.

-Eksport- import dhe tregetim me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te materialeve e paisjeve te ndertimit, te mallrave te ndryshme industrial dhe ushqimore dhe mallrave te te gjitha llojeve.

-Projektim dhe zbatim te punimeve te ndertimit dhe montimit ne godina banimi civile, industrial, bujqesore, turistike, veprave ujore, kanalizime te ndryshme, rruge ura e vepra arti, punime komunele e te mjedisit, si dhe punime te te gjitha llojet ne fushen ndertimit e montimit.

-Organizimi i udhetimeve turistike Brenda dhe jashte vendit.



Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Shqiperi dhe jashte saj.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfitojne Ortaku i Shoqerise.

Ortaku themelues perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi, ne natyre, si dhe me kapitale te derdhura nga vete ortakut.

Kapitali Themeltar i shoqerise "Sunrise Beach Hotel" shpk eshte ne vleren prej 100,000 (njeqindmije) lek, i ndare ne 1 (nje) kuote, me pjesemarje ne masen 100 % dhe kontribut i ortakut te vetem Enver Mehmeti.

Fitimet qe do te rezultojne pas miratimit te bilancit vjetor nga Ortaku i Vetem pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Divident qe i takon Ortakut Themelues.

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.

Neni 11

ADMINISTRATORI / ADMINISTRATORET

Ne shoqerine "Sunrise Beach Hotel" shpk administrator do te jete Enver Mehmeti.

Administratori emerohet per nje afat kohor prej 5 vjetesh. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori ndryshohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Mbyllja e Shoqerise:

Neni 12

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga Ortaku i Vetem, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.



Kur shoqeria likujdohet:

Neni 13

Ortaku i Vetem emeron likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

Neni 14

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Ortaku i Vetem. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve. Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

**Ortaku i Vetem i shoqrise
“Sunrise Beach Hotel” shpk**

ENVER MEHMETI

Enver Mehmeti